



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 4770 Prot.

Elbasan, më 23.09. 2025

RELACION

PËR MIRATIMIN E SHPALLJES SË ZONAVE PRIORITYARE TË ZHVILLIMIT NË TERRITORIN E BASHKISË ELBASAN

Të nderuar Këshilltar!

Në bazë të ligjit nr. 20/2025 “Për paketën e maleve”; Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 19.06.2025 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës priorityare të zhvillimit në territoret e Bashkive”. Kryetari i Bashkisë ka ngritur grupin e punës me Urdhërin nr. 454, datë 27.06.2025 me qëllim identifikimin e zonave me përparësi zhvillimi brenda territorit të Bashkisë Elbasan me përbërje si mëposhtë vijon:

- a) **Z. Asim Sula**, Kryetar me detyrë N/Kryetar i Bashkisë Elbasan.
- b) **Z. Petrit Lamçja**, Anëtar me detyrë Specialist në drejtorinë e planifikimit urban (DPPDU).
- c) **Z. Hasan Idrizi**, Anëtar me detyrë Specialist në sektorin e pyjeve dhe kullotave.
- d) **Z. Xhulian Muça**, Anëtar me detyrë Specialist në sektorin e pyjeve dhe kullotave.
- e) **Zj. Edlira Krraba**, Anëtar me detyrë Përgjegjëse e sektorit të promovimit të turizmit.
- f) **Zj. Englantina Doko**, Anëtar me detyrë Specialiste finance.
- g) **Zj. Gentiana Kerri**, Anëtar me detyrë Specialiste për pronat.
- h) **Z. Krisi Totoshi**, Anëtar me detyrë Specialist jurist.
- i) **Administratori i njësisë administrative** përkatëse, territori i të cilës synohet të jetë pjesë e zonës së zhvillimit.
- j) **Administratori i lagjes apo fshatit** përkatës, territori i të cilës synohet të jetë pjesë e zonës së zhvillimit.

Në zbatim të urdhërit të sipërcituar Grupi i Punës nën drejtimin e N/Kryetarit të bashkisë kreu detyrat e poshtëcituar brenda afatit ligjor të caktuar në urdhër:

- Identifikoj dhe bëri hartëzimin e zonës së zhvillimit brenda territorit të Bashkisë Elbasan në përputhje me parashikimet e nenit 3, shkronja ç) e ligjit nr.20/2025 “Për paketën e maleve” dhe evidentoj në terren për të verifikuar gjendjen faktike të posedimit, për të cilën mbajti procesverbalin përkatës (*bëshkëlidhur këtij relacioni*), sipas ‘Shprehjeve të Interesit’ të paraqitura online në sistemin e ngritur për këtë qëllim, por jo vetem.
- Mblodhi, administroj dhe analizoj të gjithë të dhënat e nevojshme socio-ekonomike, mjedisore dhe gjeografike si dhe çdo dokumentacion tjetër që ishte i nevojshëm në kuadër të kësaj analize, përfshirë edhe kërkesat e paraqitura nga subjekte të ndryshme në platformen dixhitale.
- Realizoj konsultimin publik me komunitetin lokal të Nj. Adm. Gjinar, Tregan, Funar dhe Shushicë.
- Bashkëpunoj me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, drejtorinë vendore Elbasan për të verifikuar statusin e pronës të poseduar nga poseduesit jopronar.

- Bashkëpunoj me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për të siguruar dhe nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të zonës së zhvillimit.
- Vlerësoj përputhshmërisë me dokumentet ekzistuese të politikave dhe planeve vendore të tilla si planin i përgjithshëm vendor, planin e menaxhimit të pyjeve.
- Vlerësoj dhe konfirmoj se zona e zhvillimit e propozuar nuk përfshin territore që janë pjesë e mosmarrëveshjeve midis bashkive kufitare, në lidhje me hartën e miratuar për territorin e bashkisë përkatëse dhe ndarjen administrativo-territoriale, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe në territorin në fjalë nuk janë të ndaluara zhvillimet ndërtimore në bazë të legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura;
- Hartoj projektaktin dhe këtë relacion shoqërues.

Dhe nga grumbullimi, bashkëpunimi, analizimi dhe verifikimi në terren të pretenduesve që synojnë të shpallen posedues jopronar arriti në përfundimin që të shpall zonat prioritare të zhvillimit, duke vlerësuar potencialin e tyre të lartë për zhvillim. Zonat e propozuara jepen si mëposhtë vijon me përshkrimin, potencialin dhe zhvillimin e mëpasshëm. Për shpalljen e zonave prioritare të zhvillimit grupi i punës ka mbajtur parasysh kërkesat e larta për turizëm (*lokal dhe ndërkombëtar*), identifikimin e llojit të turizmit të përshtatshëm për zonën dhe potencialin për zhvillim të sektorëve me prioritet. Është bërë një vlerësim i detajuar i të gjithë burimeve natyrore dhe kulturore të zonave të propozuara, vlerësimi i infrastrukturës dhe ndikimi i mundshëm në mjedis dhe shoqëri.

• **ZONAT PRIORITARE TË ZHVILLIMIT TË PROPOZUARA:**

➤ **Njësia Administrative Gjinar, Elbasan**

Gjinari gjendet në juglindje të qytetit të Elbasanit, 24 km larg tij, i arritshëm përmes rrugës automobilistike Elbasan – Gjinar. Fshati Gjinar rrethohet nga një peisazh malor, ku gërshetohen pyjet, natyra e bukur dhe trashëgimia kulturore e kulinare. Pasuritë natyrore të fshatit Gjinar e kanë ridimensionuar atë si xhevahirin natyror të qytetit të Elbasanit.

Gjinari prej vitesh tërheq mijëra vizitorë në të katër stinët e vitit pasi ofron mundësi argëtimi të shumta si hiking, kamping, ekspedita studimore apo sporte të ndryshme si rally-it etj.

Disa nga atraksionet e trashëgimisë kulturore të fshatit janë Mali i Bukanikut, destinacion për sportin e hiking; kisha e Shën Kollit, për afresket e të cilës punoi ikonografi më i njohur shqiptar Onufri; Kisha e Valeshit apo Kisha e Shën e Premtes; Kisha e Gjinarit apo edhe monumentet e natyrës si Dushku i Lleshanit, pemë shekullore, Monument Natyre; kanionet e Valeshit e të Seltës.

1. Pylltaria dhe Bimët Mjekësore

Potencial:

- Pyje të pasura me **gështenja, ah, dushk dhe pisha, livadhe alpine, burime natyrore dhe fauna e pasur.**
- Rritje natyrale e bimëve mjekësore si **boronica, trumza, rigoni, murrizi.**

Zhvillim:

- Organizimi i grumbullimit dhe përpunimit të këtyre bimëve për eksport.
- Trajnime për mbledhjen e qëndrueshme dhe çertifikimin e produkteve natyrore.
- Ndërtimi i një mini-pike për tharje dhe paketim të bimëve mjekësore.

2. Turizmi Malor dhe Ekoturizmi

Potencial:

- Peisazhe të bukura, pyje të dendur, ajër i pastër – tërheqëse për turistë vendas dhe të huaj.
- Afërsia me Elbasanin dhe Tiranën e bën lehtësisht të aksesueshme.
- Tregje me **produkte bio** si: *mjaltë, gështenja, boronica, çajra malorë.*

Zhvillim:

- Zhvillimi i **bujtinave familjare** dhe promovimi i turizmit rural.
- Krijimi i shtigjeve për **ecje, biçikletë malore, kamping dhe alpinizëm**.
- Organizimi i eventeve vjetore (*festa Miqtë e Malit, panairë me produkte lokale*).

3. Energjia e Rinovueshme

Potencial:

- Zonë me ekspozim të mirë për **panele diellore**.

Zhvillim:

- Mbështetje për fermerët dhe banorët që duan të instalojnë sisteme diellore për vetë-përdorim.
- Projekte komunitare për energji të gjelbër dhe ulje të kostove të jetesës.

4. Burimet ujore

- Ujë i pastër malor që kalon përmes qendrës së fshatit.
- Pikë e frekuentuar për relaks, fotografi dhe freski verore.
- Liqen natyral në afërsi të Gjinari, i njohur për qetësinë dhe natyrën përreth.
- Shfrytëzohet për **shëtitje dhe vëzhgim të natyrës**.

➤ Njësia Administrative Funar, Elbasan

Rreth 20 kilometra larg qytetit të Elbasanit ndodhet një nga perlat turistike thuajse të pashkelura të qytetit të Elbasanit. Janë të paktë ata që e njohin Funarin, i cili ka nën administrimin e tij 17 fshatra dhe rrethohet nga 7 male dhe përshkohet nga tre përrenj, Zaranika, Kusha dhe Zalli i Korrës. Funari është një zonë e pasur me pyje dhe me katër liqene apo rezervuarë të ndarë dy brenda fshatit dhe dy të tjerë të fshehur pas maleve që e rrethojnë atë. E pasur me pyje pishash dhe dushku, Funari ofron një klimë të shëndetshme që nëse i shtojmë dhe gatimet tradicionale të zonës, bëhet vendi ideal për të kaluar fundjavën. Por jo vetëm kaq, kjo zonë mund të jetë një destinacion edhe për të pasionuarit pas peshkimit.

1. Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi

Historia dhe kultura e pasur: Funari dhe zona e Elbasanit janë të pasura me histori dhe tradita që mund të tërheqin turistë të interesuar për vizita kulturore, arkeologjike dhe historike.

Përmirësimi i mundësive turistike: Zona mund të zhvillohet si një destinacion turistik që ofron aktivitete të ndryshme, nga turizmi i natyrës, ecje, eskursione, deri te festivale kulturore dhe gastronomike.

Zona ka edhe elementë kulturorë si **shpella, legjenda lokale, artizanat dhe kuzhinë tradicionale**.

2. Turizmi Rural dhe Ekoturizmi

Potenciali për turizëm rural: Zona e Funarit është pjesë e një rajoni malor dhe natyror, që ofron mundësi për zhvillimin e turizmit rural dhe ekoturizmit. Të ofrohet mundësia për ekskursione, ecje, mundësi për sporte aventurë si çiklizmi dhe ngjitja malore, vizita në fshatra tradicionale që mund të jenë tërheqëse për turistët që kërkojnë një përvojë autentike dhe natyrore.

Promovimi i prodhimeve vendore: Zhvillimi i tregjeve dhe aktiviteteve që ofrojnë produkte tradicionale (*p.sh., mjaltë, djathë, perime të freskëta*) mund të rrisë vlerën e zonës dhe ta bëjë tërheqëse për vizitorët. Gjithashtu zhvillimi i bujtinave familjare dhe promovimi i turizmit rural do të sillte një zhvillim të madh ekonomik dhe social për atë zonë. Ndërtimi i Zip Line mbi liqenin e Funarit nga FSHZH është një risi për Bashkinë Elbasan dhe do rris interesimin e shumë turistëve vendas dhe të huaj.

➤ Njësia Administrative Shushicë, Elbasan

I ndodhur vetëm 4 km larg qytetit të Elbasanit, mes gjelbërimit dhe ujit të ftohtë, Bysheku është një nga pikat e preferuara jo vetëm të fundjavës, por edhe të pasditeve. Edhe pse rruga që të çon deri në këtë mrekulli të vogël të natyrës është krejtësisht e rikonstruktuar, prej vitesh mungojnë investimet. Edhe pse Bysheku është një nga fshatrat e përfshirë në projektin zhvillimor "100 fshatrat", banorët duket se ende nuk janë të qartë për mundësinë e investimeve të vogla individuale përmes bujtinave apo shërbimeve familjare. Uji i ftohtë i burimit dhe rrapet mijëra vjeçare i japin zonës hijeshinë dhe qetësinë e një fundjave larg zhurmës dhe kaosit të qytetit. Nëse kësaj do t'i shtohen edhe ushqimet tradicionale të zonës dhe disa aktivitete si hipizëm apo kënde sportive, Bysheku do të ishte i pakrahasueshëm dhe i pazëvendësueshëm për elbasanasit.

Potenciali i zhvillimit të Byshekut është i madh dhe mund të realizohet përmes një strategjie të qartë që përfshin zhvillimin e turizmit rural, përmirësimin e infrastrukturës, mbështetje për bujqësinë dhe mbrojtjen e mjedisit. Zhvillimi i qëndrueshëm, mbështetje për bizneset lokale, dhe angazhimi i komunitetit janë faktorët kyç për ta bërë Byshekun një zonë tërheqëse dhe të zhvilluar ekonomikisht.

➤ Njësia Administrative Tregan, Elbasan

Tregan është një zonë e njohur për ujërat termale të Elbasanit, të cilat janë një pasuri natyrore dhe kanë një histori të gjatë të përdorimit për qëllime shëndetësore dhe relaksuese. Këto ujëra trajtojnë sëmundje të ndryshme, duke përfshirë reumatizëm, artritin dhe probleme të sistemit të frymëmarrjes. Përveç efekteve kurative, Llixhat e Elbasanit ofrojnë një ambient të qetë dhe relaksues. Shumë njerëz vijnë këtu për të shpëtuar nga stresi i përditshëm dhe për të gëzuar një moment të qetësisë. Kozmetika e njohur "baltoterapia" kuron lëkurën, e zbut atë dhe e bën të lëmuar. Turizmi në Llixhat e Elbasanit është një nga atraksionet më të njohura të këtij qyteti dhe kjo zonë është një destinacion i preferuar për ata që duan të përfitojnë nga fuqitë shëndetësore të ujërave termale.

Turizmi natyror në zonën e Treganit të Elbasanit është një burim i pasurisë natyrore dhe një atraksion i rëndësishëm për këtë qytet. Këto ujëra termale të nxehta janë një pasuri e rrallë dhe kanë një histori të gjatë të përdorimit për qëllime shëndetësore dhe relaksuese. Në fakt, Alpet e Shqipërisë, ku ndodhen këto llixha, do të jenë një rajon që manifeston ekuilibrin midis njeriut dhe natyrës, duke ruajtur vlerat mjedisore dhe promovuar identitetin, trashëgiminë kulturore dhe historike.

Rritja e impaktit të turizmit natyror në këtë zonë do të sjellë përfitime ekonomike për komunitetet pritëse dhe organizatat që menaxhojnë këto zona natyrore. Kjo do të ndihmojë në rritjen e punësimit alternativ dhe krijimin e mundësive të reja të ardhurash për komunitetet lokale. Gjithashtu turizmi natyror do të ndihmojë në rritjen e vetëdijes për ruajtjen e pasurive natyrore dhe kulturore, jo vetëm midis vendasve, por edhe midis turistëve.

Prania e poseduesve jopronar në territorin e zonës, statusi ligjor dhe kategoria e pronës

Përkatësisht brenda Njësise Administrative Gjinar aktualisht kanë shprehur interesin rreth **51** aplikantë në platformën dixhitale me sipërfaqe të përgjithëshme rreth **150** ha, pretendues për tu shpallur posedues jopronar, për të cilët grupi i punës ka verifikuar situatën faktike në terren dhe ka mbajtur proces-verbalin përkatës. Nga verifikimi në terren dhe bashkëpunimi me ASHK Elbasan ka rezultuar se pretendimet janë në tokë shtet, me kategori të ndryshme përdorimi si *pyll, kullotë, djerr, tokë bujqësore e pandare etj.* Gjithashtu këto prona nuk janë pjesë e zonave të mbrojtura me ligj të posaçëm.

Në Njësine Administrative Shushicë kanë shprehur interesin **11** aplikantë në platformën dixhitale me sipërfaqe të përgjithëshme rreth **20** ha, pretendues për tu shpallur posedues jopronar, për të cilët grupi i punës ka verifikuar situatën faktike në terren dhe ka mbajtur proces-verbalin përkatës. Nga verifikimi në terren dhe bashkëpunimi me ASHK Elbasan ka rezultuar se pretendimet janë në tokë shtet, me kategori të ndryshme përdorimi si *pyll, kullotë, djerr, tokë bujqësore e pandare etj.* Gjithashtu këto prona nuk janë pjesë e zonave të mbrojtura me ligj të posaçëm.

Në Njësinë Administrative Tregan kanë shprehur interesin **5** aplikantë në platformën dixhitale me sipërfaqe të përgjithëshme rreth **10** ha, pretendues për tu shpallur posedues jopronar, për të cilët grupi i punës ka verifikuar situatën faktike në terren dhe ka mbajtur proces-verbalin përkatës. Nga verifikimi në terren dhe bashkëpunimi me ASHK Elbasan ka rezultuar se pretendimet janë në tokë shtet, me kategori të ndryshme përdorimi si *pyll, kullotë, djerr, tokë bujqësore e pandare etj.* Gjithashtu këto prona nuk janë pjesë e zonave të mbrojtura me ligj të posaçëm.

Në Njësinë Administrative Funar kanë shprehur interesin **13** aplikantë në platformën dixhitale me sipërfaqe të përgjithëshme rreth **50** ha, pretendues për tu shpallur posedues jopronar, për të cilët grupi i punës ka verifikuar situatën faktike në terren dhe ka mbajtur proces-verbalin përkatës. Nga verifikimi në terren dhe bashkëpunimi me ASHK Elbasan ka rezultuar se pretendimet janë në tokë shtet, me kategori të ndryshme përdorimi si *pyll, kullotë, djerr, tokë bujqësore e pandare etj.* Gjithashtu këto prona nuk janë pjesë e zonave të mbrojtura me ligj të posaçëm.

Vështirësitë e hasura për dhënien e akteve të zhvillimit të territorit (leje zhvillimi dhe ndërtimi)

Duke qënë që disa zona kadastrale brenda territorit të njësisë administrative të mësipërme janë të pa azhornuara, pra pa regjistrim fillestar, shumë poseduar faktik të pronave nuk janë pajisur me aktet përkatëse kadastrale për këtë qëllim edhe marrja e miratimeve nga organet lokale për zhvillimin e aktiviteteve të tyre ekonomike është shumë e vështirë edhe here pas here e pamundur. Gjithashtu duke parë Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Elbasan dhe Planin e Detajuar Vendor, duke qënë i papërditësuar çdo njësi strukturore ka mospërputhje me aktivitetet për zhvillim dhe ka kufizime në ndërtim. Për këtë arsye shpallja e zonave prioritare sipas ligjit të paketës së maleve do të ndihmonte shumë banorët lokal por jo vetëm si posedues faktik të pronave shtetërore që të zhvillonin aktivitetin e tyre ekonomik dhe zonat në fjalë të kishin me shumë zhvillim dhe përfitime ekonomike. Gjithashtu strukturat vendore do të kryejnë të gjithë përshtatjet e nevojshme në PPV me aktivitetet ekonomike të propozuar nga poseduesit jopronar. Suporti i bashkisë në këtë pikë do ta bënte më të thjeshtë marrjen e miratimeve përkatëse nga pushteti lokal dhe qendror.

Vlerësimi i infrastrukturës

Infrastruktura kryesore e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të mundëshme/syнуara është pothuajse ekzistuese, por duke parë fluksin dhe kërkesat e mundëshme që mund të kemi pas shpalljes së zonës zhvillimore mund të ketë ende nevojë për ndërtimin e rrugëve të reja, shërbime energjie, uji etj. Strukturat vendore të Bashkisë Elbasan duke vlerësuar kërkesat e posedueve faktik dhe plan bizneset e tyre për zhvillimin e aktivitetit të tyre ekonomik do të bëjnë të gjithë planifikimet e duhura për të marr secili prej tyre shërbimin e duhur për aktivitetin e tij. Planifikimet do të jenë në përpuethsmëri të plotë me planet e përgjithëshme vendore.



Konkluzioni

Mbi aryetimin dhe vlerësimin e të gjithë faktorëve të mësipërm grupi i punës arriti në përfundimin që zonat malore të Bashkisë Elbasan që plotësojnë plotësisht kriteret për tu përfshirë në paketën e maleve janë:

1. Njësia Administrative Gjinar
2. Njësia Administrative Shushicë
3. Njësia Administrative Funar
4. Njësia Administrative Tregan

Sqarim: Edhe pse harta për shpalljen e zonës prioritare të zhvillimit përfshinë të gjithë territorin administrativ të Njësive Administrative të mësipërme, kjo nuk do të thotë se e gjithë zona e njësië do të përdoret për aktivitet ekonomik. Por kjo gjë do të varet nga numri i kërkesave për tu shpallur posedues jopronar dhe vlerësimi i dokumentacioneve që do të sjellin bashkëlidhur kërkesës sipas udhëzimit të Kryetarit të Bashkisë.

Gjithashtu prona do të plotësoj të gjithë pikat e nenit 8, të ligjit 20/2025 Për Paketën e Maleve dhe me pas hapi i fundit është vlerësimi i plan biznesit të propozuar.

Hartat përkatëse në sistemin KRGJSH, gjenden bashkëlidhur këtij relacioni.

Kjo përfshirje do të ndihmojë në promovimin e turizmit lokal, nxitjen e ekonomisë vendore dhe ruajtjen e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe artizanale.

Përsa më sipër propozojmë që Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës së tij të miratoj Zonat e mësipërme si zona me përparësi zhvillimi për Paketën e Maleve.

KRYETARI
Gledian Llatja

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI

Asim Sula



Konc. H. Idrizi

Pranoi: A. Muça

Miratoi: E. Hazizolli

Konfirmoi: Sh. Çullhaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2025

**PËR MIRATIMIN E SHPALLJES SË ZONAVE PRIORITARE TË ZHVILLIMIT NË
TERRITORIN E BASHKISË ELBASAN**

Këshimi Bashkiak pasi shqyrtoj materialin e paraqitur nga Grupi i Punës për identifikimin dhe shpalljen e zonave prioritare të zhvillimit, brenda territorit administrativ të Bashkisë Elbasan, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 20/2025 “Për Paketën e Maleve”; Udhëzimit nr.1, datë 19.06.2025 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e Bashkive”; Urdhërit nr. 454, datë 27.06.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për identifikimin e zonave me përparësi zhvillimi”.

VENDOSI

1. Të miratoj Zonat prioritare të zhvillimit, Nj. Adm. Gjinar, Funar, Tregan dhe Shushicë në zbatim të ligjit nr. 20/2025 “Për Paketën e Maleve”.
2. Bashkia Elbasan të përcjellë të gjithë dokumentacionin përkatës pranë Ministrisë së Pushtetit Vendor për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR

Lutfi Lala

Konceptoi: Grupi Punës

Asim Sula

Petrit Lamçja

Hasan Idrizi

Xhulian Muça

Edlira Krraba

Englantini Doko

Gentiana Kerri

Kristi Totoshi

Miratuar me _____vota

Vota Pro _____vota

Vota Kundër _____vota

Vota Abstenim _____vota

Zbardhur me datë ____ / ____ 2025



NJESIA ADMINISTRATIVE SHUSHICE E SHPALLUR SI ZONE PRIORITARE PER ZHVILLIM NE BASHKINE ELBASAN.

KJO NJESI PERFSHIN : ZK.1672 FUSHE BULL, ZK.1919 HAJDARAN, ZK.3021 POLIS I VOGEL, ZK.3022 POLIS VALE, ZK.3327 SHELKAN , ZK.3445 SHUSHICE , ZK.3827 VRESHTAS.


BASHKIA ELBASAN



MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
GLEDIAN LLATJA


SHKALLA

ANETARET E KOMISIONIT

- 1.Asim Sula 
- 2.Petrit Lamcja 
- 3.Hasan Idrizi 
- 4.Xhulian Muça 
- 5.Edlira Krraba 
- 6.Eglantina Doko 
- 7.Gentiana Kerri 
- 8.Kristi Totoshi 


DATA:11/08/2025

BASHKIA ELBASAN
Rruga."Qemal Stafa"
Lagja."Brig 17 Sullmuese"
+35554400152
email: bashkiaelbasan@elbasani.gov.al
web: www.elbasani.gov.al





NJESIA ADMINISTRATIVE GJINAR E SHPALLUR SI ZONE PRIORITYRE PER ZHVILLIM NE BASHKINE ELBASAN.
 KJO NJESI PERFESHIN : ZK.1474 DERSTILE, ZK.1742 GJINAR, ZK.2481 LLESHAN, ZK.2611 MASKARTH,
 ZK.2517 LUKAN, ZK.2883 PASHTRESH , ZK.3002 POBRAT, ZK.3705 VALESH, ZK.3937 XIBRESH, ZK.2023 KAFERR,
 ZK.3718 VASJAN, ZK.3526 STERSTAN.



ANETARET E KOMISIONIT

1. Asim Sula
2. Petrit Lamçja
3. Hasan Idrizi
4. Xhulian Muça
5. Edlira Krraba
6. Eglantina Doko
7. Gentiana Kerri
8. Kristi Totoshi


DATA:11/08/2025

BASHKIA ELBASAN
 Rruga. "Qemal Stafa"
 Lagja. "Brig 17 Sulmuese"
 +35554400152
 email: bashkiaeelbasan@elbasani.gov.al
 web: www.elbasani.gov.al



NJESIA ADMINISTRATIVE FUNAR E SHPALLUR SI ZONE PRIORITYRE PER ZHVILLIM NE BASHKINE ELBASAN.

KJO NJESI PERFSHIN : ZK.1203 BIXELLE, ZK.1262 BRANESH , ZK.2145 KRRABE E VOGEL, ZK.2228 KORRE, ZK.2714 MOLLAGJESH , ZK.3040 PRECA E POSHTME , ZK.3041 PRECA E SIPERME.




ANETARET E KOMISIONIT

1. Asim Sula
2. Petrit Lamçja
3. Hasan Idrizi
4. Xhulian Muça
5. Edlira Krraba
6. Eglantina Doko
7. Gentiana Kerri
8. Kristi Totoshi

DATA:11/08/2025

BASHKIA ELBASAN
Rruga. "Qemal Stafa"
Lagja. "Brig 17 Sulmuese"
+3554400152
email: bashkiaeelbasan@elbasani.gov.al
web: www.elbasani.gov.al



NJESIA ADMINISTRATIVE TREGAN E SHPALLUR SI ZONE PRIORITARE PER ZHVILLIM NE BASHKINE ELBASAN.
KJO NJESI PËRFSHIN : ZK.3655 TUDAN, ZK.3640 TREPENISHT, ZK.3633 TREGAN, ZK.3374 SHINAVLASH,
ZK.3373 SHILBATER, ZK.2727 MUÇAN , ZK.1407 ÇIKALLESH, ZK.1203 BLERIMAS, ZK.1206 BIZHDAN, ZK.2018 KAÇIVEL .


BASHKIA ELBASAN



MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
GLEDIAN LLATJA


ANETARET E KOMISIONIT

- 1.Asim Sula
- 2.Petrit Lamcja
- 3.Hasan Idrizi
- 4.Xhulian Muça
- 5.Edlira Krraba
- 6.Eglantina Doko
- 7.Gentiana Kerri
- 8.Kristi Totoshi



DATA:11/08/2025

BASHKIA ELBASAN
Rruga."Qemal Stafa"
Lagja."Brig 17 Sulmuese"
+3554400152
email: bashkiaelbasan@elbasani.gov.al
web: www.elbasani.gov.al



NJESIA ADMINISTRATIVE TREGAN E SHPALLUR SI ZONE PRIORITARE PER ZHVILLIM NE BASHKINE ELBASAN.
KJO NJESI PËRFESHIN : ZK.3655 TUDAN, ZK.3640 TREPENISHT, ZK.3633 TREGAN, ZK.3374 SHINAVLASH,
ZK.3373 SHILBATER, ZK.2727 MUÇAN , ZK.1407 ÇIKALLESH, ZK.1203 BLERIMAS, ZK.1206 BIZHDAN, ZK.2018 KAÇIVEL .

BASHKIA ELBASAN




MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
GLEDIAN LLATJA

ANETARET E KOMISIONIT

- 1.Asim Sula
- 2.Petrit Lamçja
- 3.Hasan Idrizi
- 4.Xhulian Muça
- 5.Edlira Krraba
- 6.Eglantina Doko
- 7.Gentiana Kerri
- 8.Kristi Totoshi

DATA:

BASHKIA ELBASAN
Rruga."Qemal Stafa"
Lagja."Brig 17 Sullmuese"
+35554400152
email: bashkiaeelbasan@elbasani.gov.al
web: www.elbasani.gov.al






NJESIA ADMINISTRATIVE TREGAN E SHPALLUR SI ZONE PRIORITARE PER ZHVILLIM NE BASHKINE ELBASAN.
 KJO NJESI PËRFSHIN : ZK.3655 TUDAN, ZK.3640 TREPSENISHT, ZK.3633 TREGAN, ZK.3374 SHINAVLASH,
 ZK.3373 SHILBATER, ZK.2727 MUÇAN , ZK.1407 ÇIKALLESH, ZK.1203 BLERIMAS, ZK.1206 BIZHDAN, ZK.2018 KAÇIVEL .

BASHKIA ELBASAN




MIRATOI
 KRYETARI I BASHKISE
 GLEDIAN LLATJA

ANETARET E KOMISIONIT

- 1.Asim Sula 
- 2.Petrit Lamcja 
- 3.Hasan Idrizi 
- 4.Xhulian Muça 
- 5.Edlira Kraba 
- 6.Eglantina Doko 
- 7.Gentiana Kerri 
- 8.Kristi Totoshi 

DATA:

BASHKIA ELBASAN
 Rruga "Qemal Stafa"
 Lagja "Brig 17 Sulmuese"
 +35554400152
 email: bashkiae@elbasani.gov.al
 web: www.elbasani.gov.al



PLANVENDOSJA E PROPOZUAR PËR ZONEN PRIORITARE TË ZHVILLIMIT (NJËSIA ADMINISTRATIVE FUNAR)



SH: 1: 45 000

SHPJEGJESE

-  Kufiri i bashkisë
-  Zone zhvillimi e propozuar

PROPOZOI: GRUPI I PUNËS PËR IDENTIFIKIMIN E ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMI

PLANVENDOSJA E PROPOZUAR PËR ZONEN PRIORITARE TË ZHVILLIMIT (NJËSIA ADMINISTRATIVE TREGAN)




SH: 1: 45 000

- SHPJEGJESE**
-  Kufiri i bashkisë
 -  Zonë zhvillimi e propozuar

PROPOZOI: GRUPI I PUNËS PËR IDENTIFIKIMIN E ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMI

PLANVENDOSJA E PROPOZUAR PËR ZONEN PRIORITARE TË ZHVILLIMIT (NJËSIA ADMINISTRATIVE GJINAR)



SH: 1: 55 000

SHPJEGJESE

-  Kufiri i bashkisë
-  Zonë zhvillimi e propozuar

PROPOZI: GRUPI I PUNËS PËR IDENTIFIKIMIN E ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMI

PLANVENDOSJA E PROPOZUAR PËR ZONEN PRIORITARE TË ZHVILLIMIT (NJËSIA ADMINISTRATIVE SHUSHICË)

